



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

---

## Oda e Mjekëve të Kosovës



Raport i Punës për tremujorin e katërt

Tetor-Dhjetor, 2025

Prishtinë, Shkurt 2025

Ky raport paraqet punën e OMK-së për periudhën Tetor-Dhjetor të vitit 2025.

Raporti përmbledhë aktivitetet e të gjitha njësive organizative të OMK-së, duke u koncentruar në fushat kryesore, të cilat përbëjnë objektivat e punës së Odës

## Përmbajtja:

1. Këshilli Drejtues .....	4
2. Këshilli Mbikqyrës .....	4
3. Anëtarësimi .....	5
4. Mbikëqyrja etiko-profesionale .....	6
5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional.....	7
6. Licencimet .....	7
7. Komisioni për Çështje Etike.....	8
8. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke.....	8
9. Raporti financiar .....	9
9.1 Raporti financiar për periudhën Tetor Dhjetor 2025 .....	9
9.2 Prokurimi .....	9
10. Aktivitete të tjera .....	10
10.1. Kongresi i VII i Mjekësisë.....	10
10.2. Simpoziumi i III i Kardiologjisë - “Updates in Interventional Cardiology” 12	
10.3. Revista Mjeku – Emergjencat dhe Urgjencat Mjekësore .....	12
10.4. Marrëdhëniet ndërkombëtare .....	13
10.5. Fuqizimi Institucional përmes Partneriteteve Strategjike Financiare në Shërbim të Anëtarëve të Odës së Mjekëve të Kosovës.....	14
10.6. Bashkëpunimi profesional .....	14
11. Plani i veprimit për 2026.....	15

## 1. Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues ka mbajtur dy takime, lëndët e shqyrtuara janë si më poshtë:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën tetor - dhjetor	Vendimet/Përgjigjet sipas kërkesave/ankesave të pranuar për periudhën tetor - dhjetor	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën tetor - dhjetor	Vendime/Përgjigje për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
<b>Këshilli Drejtues i Odës</b>	19	20	1	Vendim për përgjegjësin e shfrytëzimit të numrit ISBN për librin e abstraktit për Kongresin VII Vendim për themelimin të Komisionit Ad-Hoc për dhënien e dekoratave Vendim për aprovimin të raportit të punës për tre mujorin e tretë të vitit 2025 Vendim për aprovimin të projekt buxhetit për vitin 2026	2


## 2. Këshilli Mbikqyrës

Gjatë kësaj periudhe, Këshilli Mbikqyrës i Odës së Mjekëve të Kosovës ka zhvilluar tre takime, në të cilat janë trajtuar dhe shqyrtuar çështje të rëndësishme për funksionimin e rregullt dhe transparent të institucionit. Në këto takime, Këshilli ka analizuar dhe vlerësuar Raportin e Punës për tremujorin e tretë të vitit 2025, dhe vendimet e marra nga Këshilli Drejtues, si dhe nga organet e tjera të OMK-së.


Brenda kësaj periudhe është adresuar edhe një kërkesë zyrtare, për të cilën Këshilli ka hartuar dhe përcjellë një rekomandim përkatës për Këshillin Etik, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë që i takojnë këtij organi mbikqyrës.

### 3. Anëtarësimi

Në Odën e Mjekëve të Kosovës u anëtarësuan 61 mjekë, 4 mjekë të punësuar në sektorin privat, 12 mjekë të punësuar në sektorin publik dhe 45 mjekë të papunë.



Grafikoni: Anëtarësime për periudhën kohore Tetor – Dhjetor 2025



Grafikoni: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri më datën 31 Dhjetor 2025

Gjatë kësaj periudhe janë rianëtarësuar 19 mjekë, si rezultat numri total i anëtarëve deri me datën 31 Dhjetor është 5619 mjekë.

#### 4. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Ecurinë e Mbikëqyrjes Etike dhe Profesionale, Prokurorit të odës, Gjyqit të Nderit dhe certifikatata e te kaluarës etike dhe profesionale, do të paraqesim në mënyrë tabelare.


Organi	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën tetor-dhjetor	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën tetor-dhjetor	Sanksionet e shqiptuarapër periudhën tetor- dhjetor	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën tetor- dhjetor	Lëndët në shqyrtim
<b>Prokurori i Odës</b>	31	15	17	N/A	N/A	29
<b>Këshilli Etik</b>	30	9	23	Rekomandime kolegjale 10 1 Qortim Publik	Rekomandime kolegjale 10	16
<b>Gjyqi i Nderit</b>	0	4	4	///	///	0
<b>Certifikatate të kaluarës etike</b>	///	422	///	///	///	///

Gjatë këtij tre mujori janë lëshuar 422 certifikata për të kaluarën etike dhe profesionale. 393 certifikata janë lëshuar për mjekët që kanë marrë certifikata për shtesa mbi pagë në sektorin publik Rregullorja nr. 02/2023, dhe mjekët që kanë marr certifikata edhe viteve të kaluara. Ndërsa, 29 mjekë kanë kërkuar për herë të parë të ju lëshohet certifikata mbi të kaluarën etike dhe profesionale, këto kërkesa janë realizuar dhe mjekët janë pajisur me certifikata për përdorim jashtë territorit të Republikës së Kosovës

## 5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional


Komisioni ka akredituar gjithsej 55 aktivitete, prej të cilave 23 aktivitete kanë qenë ligjërata vjetore, ndërsa 7 aktivitete janë realizuar me taksë administrative.

Gjithashtu, është marrë vendim për refuzimin e një lënde për akreditimin e aktivitetit, për shkak të mosplotësimit të kriteve përkatëse, në përputhje me rregulloren përkatëse.



## 6. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim profesional, ka lëshuar gjithësejt 252 licenca me kategoritë si në grafikun e mëposhtëm:



## **7. Komisioni për Çështje Etike**

Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar 22 kërkesa për leje-hulumtim dhe ka pranuar 6 kërkesa për raport përmbyllës.

KÇE ka nxjerr 14 Vendime aprovuese, dhe 8 kërkesa kanë kaluar për shqyrtim në periudhën vijuese. KÇE për raporte përmbyllëse ka nxjerr 2 Vendime aprovuse. 4 raporte përmbyllëse kanë kaluar për shqyrtim në periudhën vijuese.

## **8. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke**

Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së ka pranuar gjithsej 5 kërkesa për përkrahje financiare dhe 3 kërkesa për shpenzime të varrimit. Komisioni ka nxjerrë 5 vendime për aprovimin e kërkesës për ndihme financiare dhe ka nxjerr 3 vendime për aprovimin e kërkesave për shpenzime të varrimit

## 9. Raporti financiar

### 9.1 Raporti financiar për periudhën Tetor Dhjetor 2025

RAPORTI FINANCIAR DERI ME 31 DHJETOR 2025					
Gjendja në bankë me 31.12.2024					€ 843,465
1.0 Të hyrat	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2	Realizimi: TM3	Realizimi: TM4	TOTAL
1.1 Të hyrat nga anëtarësia:					
1.1.1 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€ 342,715	€ 154,314	€ 3,000	€ 3,320	€ 503,349
1.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€ 1,800	€ 3,100	€ 26,440	€ 600	€ 31,940
1.2 Licencimi	€ 13,647	€ 12,490	€ 10,625	€ 12,190	€ 48,952
1.3 Të hyrat e tjera*	€ 11,714	€ 13,220	€ 27,248	€ 30,819	€ 83,001
Të hyrat për periudhën 01.01.2025-31.12.2025					€ 667,242
<b>TOTAL TË HYRAT</b>					<b>€ 1,510,707</b>
2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2	Shpenzimet: TM3	Shpenzimet: TM4	TOTAL
2.1 Paga, medijtje dhe kontributet pensionale	€ 84,791	€ 74,775	€ 74,853	€ 79,468	€ 313,887
2.2 Material shpenzues	€ 518	€ 860	€ 639	€ 538	€ 2,554
2.3 Reprerentacioni	€ 846	€ 756	€ 778	€ 705	€ 3,085
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€ 52,796	€ 8,480	€ 37,453	€ 39,146	€ 137,875
2.5 Shpenzimet e tjera*	€ 7,347	€ 9,925	€ 5,591	€ 13,645	€ 36,508
2.6 Shpenzimet e asetëve		€ 834	€ 2,940	€ 695	€ 4,469
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€ 8,450	€ 5,150	€ 25,400	€ 6,505	€ 45,505
Shpenzimet për periudhën 01.01.2025-31.12.2025					€ 543,884
<b>Gjendja në bankë me 31.12.2025</b>					<b>€ 966,823</b>

1.2.3\* Faksimili, Faksimili i dytë, Certifikata për të kaluarën etike profesionale, Taksa për paraqitjen e provimit, Kongreset, simpoziumet, seminarët, Lejimi për hulumtime për persona juridik, Të ardhurat të tjera.

2.5\* Faksimili, Shpenzimet për botimin e revistës, Shpenzimet e ID kartelave të Odë, Shpenzime të përkthimeve/lektorimit, Medijtje për udhëtime zyrtare, Mirembajtja e softverit për financa, Shpenzimet e tel., Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit, Shpenzimet e transportit, Shpenzimet e tjera operative

### 9.2 Prokurimi

Gjatë periudhës raportuese, OMK-ja ka zhvilluar procedura të prokurimit të ndara sipas vlerës së tyre, përkatësisht procedura me vlera të vogla dhe procedura me vlera të mëdha. Datat e paraqitura më poshtë i referohen datave të njoftimit për dhënie të kontratës.

Procedura të prokurimit me vlera të vogla

Në kuadër të procedurave me vlera të vogla janë realizuar këto aktivitete:

- Më 03.10.2025 është publikuar njoftimi për dhënie të kontratës për Thirrje për Shprehje të Interesit – Trajner për mbajtjen e kursit për Ultrazërin Diagnostik të Sistemit Osteomuskular - Vlera 2,999.00 €
- Më 24.10.2025 është publikuar njoftimi për dhënie të kontratës për ndërtimin e stendave për Kongresin dhe Panairin e VII-të Mjekësor-Vlera 2,999.00 €

- Më 12.11.2025 është publikuar njoftimi për dhënie të kontratës për shërbime të transportit për OMK-në - Vlera 2,700.00 €
- Më 12.01.2026 është publikuar njoftimi për dhënie të kontratës për Thirrje për Shprehje të Interesit – Trajner për kursin e Ultrazërit Diagnostik të Sistemit Osteomuskular - Vlera 4,900.00 €

Procedura të prokurimit me vlera të mëdha

Në kuadër të procedurave me vlera të mëdha janë realizuar këto aktivitete:

- Më 06.11.2025 është publikuar njoftimi për dhënie të kontratës për furnizim me material shpenzues për zyrat e OMK-së - Vlera 18,000.00 €
- Më 19.12.2025 është publikuar njoftimi për dhënie të kontratës për Auditim Funkcional dhe Financiar të OMK-së – Vlera 4,380.00 €

Të gjitha procedurat e lartcekura janë zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndërsa kontratat janë lidhur brenda afateve të parapara.

## **10. Aktivitete të tjera**

### **10.1. Kongresi i VII i Mjekësisë**

*Tema: Emergjenca, Kujdesi Intensiv dhe Anestezioni në Krisa Mjekësore*

Ndër aktivitetet kryesore që Oda e Mjekëve ka planifikuar të realizoj për vitin 2025 është Kongresi Mjekësor. Kongresi është paraparë që të jetë i fokusuar në lëminë e Emergjencës, Kujdesit Intensiv dhe Infektologjisë, specifikisht specilizimet (Anestezilogjia, Emergjenca dhe Infektologjia). Organizimi i Kongresit të Shtatë të Mjekësisë ka filluar në muajin Prill 2025, ku OMK kishte formuar Këshillin Organizativ dhe Shkencor të përbërë gjithësej nga 21 anëtarë.

Dinamika:

- Qershor deri 01 Shtator - Hapja e mundësisë për regjistrim të pjesëmarrësve
- 16 Qershor - Hapja e afatit për pranimin i abstrakteve
- 01 Shtator - Mbyllja e afatit për pranimin i abstrakteve
- 01 Tetor - Njoftimi i autorëve

21, 22 dhe 23 Nëntor mbahen punimet e Kongresit.

Me datë 10 Qershor është bërë hapja e mundësisë për regjistrim të pjesëmarrësve. Në web faqen zyrtare të Odës, është vendosur butoni ku është bërë regjistrimi për pjesëmarrje në

kongres. Gjithashtu edhe në Facebook të Odës është shpërndarë linku i regjistrimit për pjesëmarrje në kongres si dhe njoftimi është bërë edhe përmes e-mailit të të gjithë anëtarët e Odës. Numri i parapraë për regjistrim është plotësuar brenda 72 orëve pas hapjes së mundësuar ku ka arritur numrin 2000.

Përgjat dy ditëve të kongresit ka pasur interesim shumë të madh për ta ndjekur ko, ku 976 pjesëmarrës janë regjistruar në ditën e parë ndërsa 894 është bërë në ditën e dytë. Sipas pikëve 975 pjesëmarrës pasiv kanë ndjekur të dy ditët e ligjeratave dhe 160 kanë ndjekur vetëm një ditë punimet e Kongresit.

Pjesëmarrja në kongres për të gjithë anëtarët e Odës së Mjekëve të Kosovës ka qenë pa pagesë.

Afati për dorëzimin e abstrakteve sipas kriterëve të vendosura nga këshilli shkencor ka qenë nga data 16 Qershor deri me 01 Shtator. Janë pranuar 56 abstrakte. Abstraktet u janë dërguar të gjithë anëtarëve të Këshilli Shkencor përmes emailit për vlerësim.

Me propozime nga Këshilli Shkencor dhe Këshilli organizativ janë 50 ligjerues te ftuar. Pjesëmarrja e ligjeruesve të ftuar do të jetë e kombinuar, 46 prej ligjeruesve e kane konfirmuar pjesëmarrjen në mënyrë fizike.

Në këtë Kongres është organizuar një punëtori dyditore, e cila është mbajtur paralelisht me punimet e Kongresit. Në punëtori kanë marrë pjesë target-grupe të fushave specialistike, por të fokusuara vetëm në Anesteziologjinë Pediatrike.

Temat e punëtorisë kanë qenë:

- Kursi i Mbështetjes së Jetës Perioperative Pediatrike ASPA (PPLS)
- Trajnimi i Trajnerëve (TTT) (ASPA Paediatric Perioperative Life Support Course – PPLS and Train the Trainers – TTT)

Në kuadër të këtij Kongresi është organizuar edhe Panairi Mjekësor, si edicioni i shtatë i tij, ku kompanitë pjesëmarrëse prezantuan produktet dhe shërbimet e tyre në Pavionin Mjekësor, me produkte të ekspozuara gjatë gjithë ditëve të panairit.

Panairi ka qenë i hapur për dy ditë me radhë, paralelisht me punimet e Kongresit të VII të Mjekësisë, duke u ofruar anëtarëve të OMK-së mundësinë të shohin nga afër produktet dhe risitë e prezantuara, në total kanë marrë pjesë 10 kompani.

## **10.2. Simpoziumi i III i Kardiologjisë - “Updates in Interventional Cardiology”**

Oda e Mjekëve të Kosovës së bashku me projektin e qeverisë së Luxemburgut KSV/017 dhe në bashkëpunim me National Institute Surgery Cardiac and De Cardiologie Interventionnelle (INCCI) me datë 22 nëntor 2025, organizuan simpoziumin e III me pjesëmarrje ndërkombëtare nga lëmia e kardiologjisë me temë “Updates in Interventional Cardiology”.

Disa nga temat që u trajtuan në këtë simpozium janë:

- Sindroma akute koronare në Kosovë gjatë 25 viteve të fundit
- On the quest for a National cardiac Center in Kosovo insides from INCCI in Luxembourg over the last 30 years
- Përvoja e Shqipërisë në luftën kundër sëmundjeve kardiovaskulare
- Biomarkues e rinj në No-Reflow Fennomen, etj.

Ky simpozium u organizua me qëllim të ngritjeve të kapaciteteve profesionale dhe kishte për target gurrp Kardiologët, Kardiokirurgët si dhe specialist të Mjekësisë Interne

## **10.3. Revista Mjeku – Emergjencat dhe Urgjencat Mjekësore**

Ky numër është publikuar gjatë muajit Nëntor 2025 dhe përbëhet gjithsej prej 21 artikujve të përmbledhur në 80 faqe. Artikujt trajtojnë Emergjencat dhe Urgjencat Mjekësore, duke përfshirë menaxhimin e traumave të ndryshme, situatat akute që rrezikojnë shëndetin e fëmijëve dhe problemet kritike që prekin të rriturit, ndërlidhet dhe shërben si mbështetje për Kongresin e VII të Mjekësisë me të njejtën temë, të organizuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës.

Gjithashtu pjesë e këtij numri për herë të parë është edhe suplementi shkencor që përmban 9 artikuj në gjuhën angleze dhe ka 37 faqe. Ndërsa si përmbajtje ky suplement trajton tema të ndryshme të mjekësisë si artikuj origjinal.

Emergjencat dhe Urgjencat Mjekësore/ Supplement është publikuar në faqen zyrtare të facebookut dhe Web-faqen e OMK-së ku mund të shikohet nga publiku i gjerë

<https://omk-rks.org/ëp-content/uploads/REVISTA-MJEKU-VELLIMI-5-NUMER-4-Emergjencat-dhe-Urgjencat-Supplement.pdf>

#### **10.4. Marrëdhëniet ndërkombëtare**

*Mbledhja e Komitetit të Përhershëm Evropian të Mjekëve (CPME).*

Komiteti i Përhershëm Evropian i Mjekëve (CPME) në muajin Tetor mbajti punimet e rregullta 6 mujore. Takimi i rradhës është mbajtur në Athinë, ku përfaqësuesi I Odës së Mjekëve të Kosovës morri pjesë në punimet e takimit të radhës së Komitetit të Përhershëm Evropian të Mjekëve (CPME).

Nikoqiri i këtij takimi ishte Asociacioni Panhelenik i Mjekëve. Ky takim mblodhi përfaqësues të lartë të organizatave mjekësore nga e gjithë Evropa dhe trajtoi çështje me rëndësi të veçantë për politikën shëndetësore evropiane, përfshirë optimizimin e shërbimeve shëndetësore, të drejtat e pacientëve, shëndetin publik dhe parandalimin e sëmundjeve, si dhe digjitalizimin e sistemit shëndetësor.

*100 vjetori i themelimit të Asociacioni Panhelenik i Mjekëve*

Në vazhden e angazhimeve ndërkombëtare të Odës së Mjekëve të Kosovës, pas pjesëmarrjes në punimet e Komitetit i Përhershëm i Mjekëve Evropianë (CPME) në Athinë, përfaqësimi institucional u thellua edhe më tej përmes pjesëmarrjes në një ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare.

Me ftesë të Asociacionit Panhelenik të Mjekëve, përfaqësuesi i OMK-së mori pjesë në shënimin e 10 -vjetorit të Asociacioni Panhelenik i Mjekëve, i cili u mbajt më 13 dhjetor 2025 në Athinë. Gjatë ceremonisë u prezantua rrugëtimi historik njëqindvjeçar i këtij asociacioni, duke vënë theksin në kontributin e tij në zhvillimin e sistemit shëndetësor, si dhe u diskutuan sfidat bashkëkohore dhe perspektivat e ardhshme të profesionit mjekësor në nivel evropian dhe global.

Në kuadër të kësaj vizite, përfaqësuesi i OMK-së zhvilloi një takim të veçantë me Dr. Jacqueline Kitulu, Presidente e Shoqata Botërore e Mjekëve (WMA), gjatë të cilit u diskutua për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe u avancuan bisedimet lidhur me anëtarësimin e Odës së Mjekëve të Kosovës në këtë organizatë prestigjioze botërore.

Këto aktivitete përbëjnë një vazhdimësi të drejtpërdrejtë të angazhimeve të Odës në arenën ndërkombëtare gjatë këtij tremujori, duke dëshmuar përkushtimin institucional për rritjen e prezencës ndërkombëtare, ndërtimin e partneriteteve strategjike dhe promovimin e interesave profesionale të mjekëve të Kosovës në organizata mjekësore evropiane dhe botërore.

### **10.5. Fuqizimi Institucional përmes Partneriteteve Strategjike Financiare në Shërbim të Anëtarëve të Odës së Mjekëve të Kosovës**

Oda e Mjekëve të Kosovës ka shënuar zhvillime të rëndësishme në drejtim të fuqizimit institucional dhe përmirësimit të shërbimeve për anëtarët e saj, përmes thellimit të bashkëpunimeve strategjike me partnerë financiarë.

Oda e Mjekëve të Kosovës ka nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit me ProCredit Bank, marrëveshje e cila synon përmirësimin e pozitës financiare të mjekëve dhe lehtësimin e qasjes së tyre në produkte dhe shërbime bankare me kushte të favorshme dhe ekskluzive. Ky partneritet përfaqëson një hap strategjik në mbështetje të profesionistëve shëndetësorë, duke kontribuar në krijimin e kushteve më të mira për stabilitet financiar, zhvillim profesional dhe mirëqenie afatgjatë për mjekët.

Po ashtu, gjatë këtij tremujori është formalizuar edhe marrëveshja e bashkëpunimit me Vllesa Pagesa, e cila mundëson që anëtarët e Odës të realizojnë pagesat e faturave të pranuar nga Oda në të gjitha degët e kësaj kompanie të specializuar për shërbime financiare. Ky bashkëpunim synon rritjen e efikasitetit administrativ dhe lehtësimin e proceseve të pagesave për anëtarësinë, duke ofruar qasje më të shpejtë dhe më praktike në shërbimet përkatëse.

### **10.6. Bashkëpunimi profesional**

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Këshilli Etik i OMK-së, Prokurori i OMK-së, ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën tetor - dhjetor	Vendimet sipas urdhëresave/kërkesave të pranuar për periudhën tetor - dhjetor	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën tetor - dhjetor	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
<b>Kryetari i Odës</b>	3	3	0	0	0

## 11. Plani i veprimit për 2026

- Vazhdimi i realizimit të Projektit për ndërtimin e objektit për të gjitha OPSH- të, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për sektorin e shëndetësisë” dhe OPSH-të. Në këtë fazë sipas procedurave administrative dhe hapave të planifikuara deri në përfundim të projektit, kemi pranuar lejen për kushtet ndërtimore nga komuna e Prishtinës, është bërë plani detal i objektit nga arkitektët dhe gjithahtu OPSH-të së bashku me projektin Luxembourg Development kanë përfunduar procedurat e prokurimit për fillimin e punimeve dhe është përzgjedhur operatori ekonomik për zhvillimin e punimeve të objektit. Hapi i ardhshëm i projektit është fillimi i punime për ndërtim.
- Botimi i numrave në vazhdimësi të “Revista Mjeku”.
- Fillimi i botimit të numrit shkencor të “Revista Mjeku”.
- Vazhdimi i zbatimit të projekteve për profilizim jashtë vendit, bazuar në marrëveshjen mes OMK-së dhe SHSKUK.
- Organizimi i zgjedhjeve për legjislaturën e IV të OMK-së.
- Lansimi i modulit për EVP dhe regjistrimi i të gjitha shoqatave në platformën digjitale
- Ndërlidhja e platformës digjitale me ekosovën